



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 27 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris  
Valon Hasani

**Mbrojtësit kujdestar të Nasim  
Haradinajt**  
Bastian Martens

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 39(3), (13) dhe 41(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave përkatës për transferim kundër Hysni Gucatit (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”).<sup>2</sup>

2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj (bashkërisht “të dyshuarit”),<sup>3</sup> së bashku me urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar konfidencial i kërkesës urgjente për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to (“Kërkesa e ZPS-së për fletarrestime”)*, 1 tetor 2020, konfidencial, me shtojcat 1-2, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin (“Fletarrestimi për z. Gucati”)*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Nasim Haradinajn (“Fletarrestimi për z. Haradinaj”)*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

3. Të dyshuarit u arrestuan në Kosovë më 25 shtator 2020.<sup>5</sup> Z. Gucati u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më të njëjtën ditë.<sup>6</sup> Z. Haradinaj u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më 26 shtator 2020.<sup>7</sup>
4. Më 29 shtator 2020, mbrojtësi kujdestar i z. Haradinaj ("Mbrojtja e z. Haradinaj") paraqiti kërkesë për "Paraqitjen e parë, mocionin për hedhjen poshtë të akuzave dhe mocionin për lirim të menjëhershëm".<sup>8</sup>
5. Më të njëjtën ditë, mbrojtësi i z. Gucati ("Mbrojtja e z. Gucati") paraqiti tri kërkesa që kundërshtonin ligjshmërinë e arrestimit të z. Gucati,<sup>9</sup> dhe një kërkesë për lirim të përkohshëm.<sup>10</sup>
6. Më 2 tetor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Vetëm,<sup>11</sup> ZPS-ja paraqiti përgjigjen ndaj kërkesës së Mbrojtjes së z. Haradinaj.<sup>12</sup>

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik; F00016, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00030, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Paraqitja e parë, mocion paraprak për hedhjen poshtë të akuzave dhe mocion për lirim të menjëhershëm ("Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj")*, 29 shtator 2020, publike.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00032, Mbrojtja e z. Gucati, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2): Kërkesë për caktimin e një gjykatësi tjetër për të vendosur në lidhje me kundërshtimin ("Kërkesa e parë e Mbrojtjes së z. Gucati")*, 29 shtator 2020, publike; F00033, Mbrojtja e z. Gucati, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2): Kërkesë për dhënie të informacionit ("Kërkesa e dytë e Mbrojtjes së z. Gucati")*, 29 shtator 2020, publike; F00034, Mbrojtja e z. Gucati, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm ("Kërkesa e tretë e Mbrojtjes së z. Gucati")*, 29 shtator 2020, publike.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-07, F00038, Mbrojtja, *Kërkesë për dorëzani*, 29 shtator 2020, publike.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-07, Paraqitja e parë e z. Haradinaj, 29 shtator 2020, Transkripti publik zyrtar, f. 15, rreshtat 18-22.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-07, F00039, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj parashtrimit të protokolluar KSC-BC-2020-07/F00030 ("Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt")*, 2 tetor 2020, publike.

7. Më 9 tetor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Vetëm,<sup>13</sup> ZPS-ja paraqiti përgjigjen përmbledhëse për të katër kërkesat e Mbrojtjes së z. Gucati.<sup>14</sup>

8. Mbrojtja e z. Haradinaj dhe Mbrojtja e z. Gucati (së bashku, "Mbrojtja") nuk paraqitën kundërpërgjigje ndaj përgjigjeve të ZPS-së brenda afatit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe as nuk paraqitën kërkesë për zgjatjen e afatit.

9. Më 20 tetor 2020, Mbrojtja e z. Gucati paraqiti kërkesë ku kërkonte seancë gojore para Gjykatësit të Vetëm të caktuar rishtazi dhe seancë para panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>15</sup>

10. Më 21 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi përgjigje ndaj kërkesës së Mbrojtjes së z. Gucati për seancë gojore.<sup>16</sup>

11. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja e z. Gucati paraqiti një njoftim tjetër në lidhje me përgjigjen e ZPS-së ndaj kërkesës për seancë gojore.<sup>17</sup>

12. Më 27 tetor 2020, Mbrojtja e z. Gucati paraqiti edhe një kërkesë për përgjigje urgjente nga Dhomat e Specializuara ndaj kërkesave të tij të mëhershme për seancë gojore.<sup>18</sup>

---

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-07, Paraqitja e parë e z. Gucati, 1 tetor 2020, Transkript publik zyrtar, f. 7, rreshtat 13-19.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-07, F00045, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirim* ("Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucati"), 9 tetor 2020, publike.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-07, F00052, Mbrojtja e z. Gucati, *Kërkesë për seancë gojore*, 20 tetor 2020, konfidenciale.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-07, F00053, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së Mbrojtjes për seancë gojore*, 21 tetor 2020, konfidenciale.

<sup>17</sup> KSC-BC-2020-07, F00054, Mbrojtja e z. Gucati, *Njoftim tjetër në lidhje me përgjigjen e Prokurorisë ndaj kërkesës së Mbrojtjes për seancë gojore*, 21 tetor 2020, konfidenciale.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-07, F00056, *Kërkesë për përgjigje urgjente nga Dhomat e Specializuara: Në lidhje me F00052 dhe F00054*, 27 tetor 2020, publike.

## II. PARASHTRIMET

13. Mbrojtja e z. Haradinaj kërkon nga Gjykatësi i Vetëm që, ndër të tjera, të përcaktojë se akuzat nuk bien brenda juridiksionit të DHS-së, të hedhë poshtë akuzat dhe t'i japë Mbrojtjes të gjitha dokumentet dhe materialet në mbështetje të aktakuzës.<sup>19</sup>

14. ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Vetëm duhet të hedhë poshtë kërkesën e Mbrojtjes së z. Haradinaj në tërësi.<sup>20</sup>

15. Mbrojtja e z. Gucati kërkon nga Gjykatësi i Vetëm që, ndër të tjera, t'i japë fund detyrës se vet në mënyrë që një gjykatës tjetër të shqyrtojë kundërshtimet e Mbrojtjes,<sup>21</sup> të urdhërojë nxjerrjen e të gjithë materialit dhe provave ose fakteve përkatëse në posedim të ZPS-së,<sup>22</sup> dhe të konstatojë mungesën e autoritetit të ligjshëm të fletarrestimit të lëshuar kundër z. Gucati.<sup>23</sup>

16. ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Vetëm duhet të hedhë poshtë të gjitha kërkesat e Mbrojtjes së z. Gucati.<sup>24</sup>

## III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

17. Në përputhje me nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion, *ndër të tjera*, mbi nenet 395, 396 dhe 400 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji nr. 04/L-082 ("KPK 2012"). Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Ligji nr. 06/L-074 ("KPK 2019"), këto dispozita u rinumërtuan përkatësisht, nenet 387, 388 dhe 392.

---

<sup>19</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 8.

<sup>20</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 14.

<sup>21</sup> Kërkesa e parë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 4.

<sup>22</sup> Kërkesa e dytë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 11.

<sup>23</sup> Kërkesa e tretë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 17.

<sup>24</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucatit, para. 13.

18. Në pajtim me nenin 33(1)(a) dhe (2) të Ligjit, Kryetari i Dhomave të Specializuara ("Kryetarja") cakton, përkatësisht, gjykatësin e procedurës paraprake pas ngritjes së aktakuzës ose Gjykatësin e Vetëm për t'u marrë me çështje që kërkon caktimin e një gjykatësi të ndryshëm nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

19. Në pajtim me nenet 33(2), 39(3) dhe (13) të Ligjit, Gjykatësi i Vetëm mund të lëshojë çfarëdo urdhri të nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

20. Në përputhje me nenin 41(6)(a) të Ligjit, Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar arrestojnë një person vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer krim brenda juridiksionit të DHS-së. Në përputhje me nenin 41(4)(a) të Ligjit, pas arrestimit, personi informohet menjëherë për arsyet e arrestimit, në një gjuhë që e kupton.

21. Në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit, apelet e ndërmjetme, me përjashtim të atyre kundër vendimeve apo urdhrave që kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim ose të mocioneve paraprake që kundërshtojnë juridiksionin e DHS-së, duhet të lejohen mbi bazën se kanë të bëjnë me çështje që do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe për të cilat, sipas mendimit të trupit gjykues që jep miratimin, një vendim i menjëhershëm i panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

#### IV. DISKUTIM

##### A. JURIDIKSIONI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

22. Mbrojtja e z. Haradinaj deklaron se Dhomat e Specializuara nuk kanë juridiksion për të gjykuar z. Haradinaj sepse: (i) "ai u arrestua [...] për t'u paraqitur [...] për akuza

që nuk kanë të bëjnë me krime lufte”;<sup>25</sup> (ii) DHS-ja nuk ka juridiksion lëndor mbi nenin 387 të Ligjit;<sup>26</sup> (iii) veprat që mbulojnë prej neneve 387, 388 dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës bien jashtë juridiksionit kohor të DHS-së, siç përcaktohet në nenin 7 të Ligjit;<sup>27</sup> dhe (iv) veprat e pretenduara të z. Haradinaj nuk kanë të bëjnë me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e DHS-së.<sup>28</sup> ZPS-ja përgjigjet se nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit përcaktojnë që DHS-ja ka juridiksion mbi vepra penale që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë, përfshirë nenet 387, 388 dhe 392, me numrat e rinj në KPK-në e vitit 2019.<sup>29</sup> ZPS-ja më tej parashtron se, meqenëse vepra penale të tilla duhet të kenë lidhje me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e DHS-së ose të ZPS-së, juridiksioni kohor për krime të tilla domosdoshmërisht shtrihet përtej periudhës kohore të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit.<sup>30</sup> Për më tepër, ZPS-ja argumenton se hetimet dhe akuzat e saj përbëjnë procedura penale brenda kuptimit të neneve 387 dhe 392 të KPK-së 2019.<sup>31</sup>

23. Në lidhje me juridiksionin lëndor të Dhomave të Specializuara, Gjykatësi i Vetëm kujton se neni 6 i Ligjit i jep DHS-së juridiksion për krime kundër njerëzimit (neni 13 i Ligjit), krime të luftës (neni 14 i Ligjit), krime të tjera sipas ligjeve të Kosovës (neni 15(1) i Ligjit) si dhe për krime të përcaktuara konkretisht kundër administrimit të drejtësisë, kur kanë të bëjnë me “procedura zyrtare dhe zyrtarë të Dhomave të Specializuara, Zyrës Administrative dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar” (neni 15(2) i Ligjit).

---

<sup>25</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 2.

<sup>26</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 6. Gjykatësi i Vetëm supozon se Mbrojtja e z. Haradinaj në fakt i referohej neni 387 të Kodit Penal të Kosovës.

<sup>27</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 6.

<sup>28</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 4.

<sup>29</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 3.

<sup>30</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 3.

<sup>31</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 5.

24. Në lidhje me dispozitat e përmendura në nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit, Gjykatësi i Vetëm vë në dukje se numrat e renditur i referohen KPK-së 2012, që ishte në fuqi në kohën kur u miratua Ligji. Në KPK-në e vitit 2019, që hyri në fuqi më 14 prill 2019,<sup>32</sup> ato dispozita u rinumërtuan.<sup>33</sup> Duke marrë parasysh se qëllimi i ligjvënësve ka qenë qartësisht që Dhomave të Specializuara t'u jepej juridiksion mbi këto vepra penale dhe në pajtim me parimin se personat duhet të ndiqen penalisht dhe dënohen në pajtim me ligjet në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale të pretenduara,<sup>34</sup> procedurat aktuale bazohen në nenet 387, 388 dhe 392 të KPK-së 2019.

25. Sa i përket juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, Gjykatësi i Vetëm kujton se veprat penale të renditura në nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit kanë të bëjnë me zyrtarë ose procedura zyrtare të DHS-së dhe ZPS-së dhe për këtë arsye duhet të kenë lidhje me ngjarje që kanë ndodhur pas krijimit të këtyre institucioneve. Rrjedhimisht, juridiksioni kohor i Dhomave të Specializuara shtrihet përtej fushëveprimit të nenit 7 të Ligjit, kur është fjala për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

26. Në lidhje me veprat e pretenduara të z. Haradinaj dhe lidhjen e tyre me procedurat zyrtare të DHS-së, Gjykatësi i Vetëm kujton se pretendohet që të dyshuarit kanë publikuar dhe shpërndarë dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë të bëjnë me hetimet e ZPS-së.<sup>35</sup> Gjykatësi i Vetëm rithekson konstatimin e tij se hetimet e ZPS-së përbëjnë procedura zyrtare në lidhje me veprat penale të nenit 15(2) të Ligjit.<sup>36</sup>

---

<sup>32</sup> *Shih* neni 434 i KPK-së 2019, i botuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*, nr. 2, 14 janar 2019, Prishtinë.

<sup>33</sup> Nenet 384-386, 388, 390-407, 409-411, 415, 417, 419, 421 dhe 423-424 të KPK-së 2012 janë bërë nenet 376-378, 380, 382-399, 401-403, 407, 409, 411, 413 dhe 416-417 të KPK-së 2019.

<sup>34</sup> Neni 33(2) dhe(4) i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>35</sup> KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra për transferim* ("Vendimi për fletarrestime"), 24 shtator 2020, publik, para. 21, 26 dhe 29.

<sup>36</sup> Kujtojmë gjithashtu se KPK-ja 2019 dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës i vitit 2012, Ligji Nr. 04/L-123 ("KPPK") shprehimisht përfshijnë hetimet e prokurorisë brenda fushëveprimit të "procedurave zyrtare". Neni 376 i KPK-së 2019 i përkufizon "procedurat zyrtare" si ato që përfshijnë procedurat penale të përkufizuara në KPPK. Neni 6(2) i KPPK-së parasheh që "procedura penale



27. Për sa më lart, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kundërshtimet e mësipërme në lidhje me juridiksionin janë të pabaza.

#### B. LËSHIMI I FLETARRESTIMEVE PËRPARA PARAQITJES SË AKTAKUZËS

28. Mbrojtja e z. Gucati parashtron se, në pajtim me nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 85(1) të Rregullores: (i) arrestimi dhe transferimi i një personi në Dhomat e Specializuara mund të ndodhë vetëm pas parashtrimit të aktakuzës;<sup>37</sup> dhe (ii) vetëm Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë fletarrestim.<sup>38</sup> ZPS-ja përgjigjet se Ligji dhe Rregullorja parashohin arrestimin, transferimin dhe paraburgimin e personave para konfirmimit të aktakuzës.<sup>39</sup>

29. Sa i përket arrestimit të një personi nga Dhomat e Specializuara para parashtrimit të aktakuzës, Gjykatësi i Vetëm vë në dukje se asgjë në formulimin e nenit 41 të Ligjit nuk sugjeron se arrestimi i një personi kushtëzohet nga parashtrimi apo konfirmimi i aktakuzës. Në fakt, standardi i nevojshëm sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit për arrestimin e një personi (dyshimi i bazuar) është i ndryshëm nga standardi i përcaktuar në nenin 38(4) të Ligjit (dyshimi i bazuar mirë) për parashtrimin e aktakuzës. Duke i konsideruar përkufizimet e këtyre termave në KPPK,<sup>40</sup> Gjykatësi i Vetëm nënvizon se “dyshimi i bazuar mirë” është domosdoshmërisht më i rëndë se “dyshimi i bazuar” dhe, si rezultat, një person mund të arrestohet nga Dhomat e Specializuara pa u

---

fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer veprë penale”. Neni 101 i KPPK-së rregullon “fillimin e procedurave penale me fazën hetimore ose me aktakuzë”. *Shih gjithashtu* Vendimi për fletarrestime, para. 17, 26, poshtëshënimi 44.

<sup>37</sup> Kërkesa e tretë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 7.

<sup>38</sup> Kërkesa e tretë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 6, 9, 11, 13-15.

<sup>39</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucatit, para. 2.

<sup>40</sup> Sipas nenit 19.1.12 të KPPK-së, dyshimi i bazuar mirë arrihet kur posedimi i provave “do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”. Sipas nenit 19.1.9 të KPPK-së, dyshimi i bazuar arrihet kur dijenia e informacionit “do ta bindte një vëzhgues objektiv se personi në fjalë ka më shumë të ngjarë që të ketë kryer veprë penale sesa që të mos e ketë kryer atë”.

dorëzuar aktakuza kundër tij. Kjo konfirmohet më tej nga dispozita të tjera të Ligjit dhe të Rregullores. Në veçanti, neni 39(4) i Ligjit parasheh arrestimin e një personi të akuzuar “nëse nuk është tashmë në paraburgim”. Rregulla 57(1) të Rregullores përcakton procesin e rishikimit dhe kohëzgjatjen e paraburgimit para caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese nuk ka konstatuar asnjë mospërputhje midis rregullës 57(1) të Rregullores dhe Kushtetutës.<sup>41</sup> Për më tepër, neni 35(2)(h) i Ligjit e lejon Prokurorin e Specializuar që të arrestojë një person në kushte të caktuara “gjatë fazës së hetimeve” dhe neni 41(3) i Ligjit lejon zgjatjen e paraburgimit të personit të tillë nga një gjykatës i Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, arrestimi i një personi përpara parashtrimit të aktakuzës lejohet shprehimisht sipas kornizës ligjore të DHS-së, nëse përmbushet standardi i përcaktuar në nenin 41(1)(a) të Ligjit.

30. Sa i përket kompetencës për lëshimin e fletarrestimeve, Gjykatësi i Vetëm kujton se, në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake caktohet vetëm pas parashtrimit të aktakuzës dhe se një caktimi i tillë përfundon 30 ditë pas formimit të trupit gjykues, ose më vonë nëse e kërkojnë rrethanat. Kjo domosdoshmërisht do të thotë se arrestimi i një personi jashtë periudhës së caktimit të gjykatësit të periudhës paraprake do të duhej të urdhërohet dhe/ose të rishikohet nga një tjetër gjykatës i DHS-së. Para parashtrimit të aktakuzës, një gjykatës i tillë domosdoshmërisht do të ishte gjykatësi i vetëm i caktuar në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit. Ligji dhe Rregullorja e konfirmojnë këtë interpretim dhe i referohen “Dhomave të Specializuara” (nenet 41, 53(3) të Ligjit; rregulla 55(4) e Rregullores),

---

<sup>41</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Proovave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 Dhomes së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05-L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 26 prill 2017, publik, para. 123. KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi referimin e amendamenteve të Rregullores së Procedurës dhe të Proovave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj 2020*, para. 64-68.

“panelit”<sup>42</sup> (rregullat 48(2), 53(1), 54, 56 të Rregullores) dhe “gjykatësit të vetëm” (rregulla 57(1) e Rregullores) kur jepet autoriteti gjyqësor në lidhje me arrestimet. Rrjedhimisht, Ligji dhe Rregullorja nuk i japin vetëm Gjykatësit të Procedurës Paraprake kompetencë për lëshimin e fletarrestimeve.

31. Për sa më sipër, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kundërshtimet e lartpërmendura në lidhje me lëshimin e fletarrestimeve para parashtrimit të aktakuzës janë të pabaza.

### C. CAKTIMI I GJYKATËSIT TË VETËM

32. Mbrojtja e z. Gucati parashtron se, në pajtim me nenin 33(1)(a), (2) të Ligjit, caktimi i Gjykatësit të Vetëm është i përkohshëm dhe se duhet të caktohet një gjykatës tjetër për të vendosur për kundërshtimet ndaj arrestimit.<sup>43</sup> ZPS-ja përgjigjet se vendimi i Kryetares për caktimin e Gjykatësit të Vetëm shprehimisht parashikonte lëshimin, ndër të tjera të fletarrestimeve dhe vendimeve për transferim dhe ky caktim vazhdon të përfshijë të gjitha çështjet që i paraprijnë parashtrimit të aktakuzës, përfshirë kundërshtimet e paraqitura ndaj arrestimit.<sup>44</sup>

33. Fillimisht, Gjykatësi i Vetëm kujton vendimin e Kryetares për caktimin e Gjykatësit të Vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit (“Vendimi i caktimit”),<sup>45</sup> sipas të cilit, qëllimi i neneve 25(1)(f) dhe 33(2) të Ligjit është që të ngërthejë ato raste kur është i nevojshëm caktimi i një gjykatësi të vetëm për t’u marrë me një çështje konkrete pa u aktivizuar kushtet për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit.<sup>46</sup> Vendimi i caktimit e ka përkufizuar shkakun e caktimit

<sup>42</sup> Rregulla 2(1) e Rregullores e përkufizon panelin si "cilido panel/trup gjykues ose gjykatës i caktuar në pajtim me nenin 25(1) dhe 33 të Ligjit, përveç nëse saktësohet ndryshe".

<sup>43</sup> Kërkesa e parë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 3-5.

<sup>44</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucati, para. 2.

<sup>45</sup> KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit* (“Vendimi i caktimit”), 29 maj 2018, publik.

<sup>46</sup> Vendimi i caktimit, para. 11.

të Gjykatësit të Vetëm si “çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor e parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës”,<sup>47</sup> dhe, për të siguruar zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të kërkesave të tilla, Aty gjithashtu pohohet se Gjykatësi i Vetëm do të ishte kompetent për të shqyrtuar të gjitha kërkesat e ardhshme të tilla dhe çështjet e lidhura me to.<sup>48</sup> Në këtë aspekt, Vendimi i caktimit parashikonte konkretisht, ndër të tjera, lëshimin e fletarrestimeve, fletëthirrjeve, vendimeve ose urdhrave të tjerë, në përputhje me nenet 39 dhe 41 të Ligjit.<sup>49</sup> Rrjedhimisht, lëshimi i fletarrestimeve kundër të dyshuarve si dhe shqyrtimi i kundërshtimeve aktuale ndaj ligjshmërisë së tyre është në kompetencën e Gjykatësit të Vetëm, siç parashihet në Vendimin e caktimit.

34. Për sa më sipër, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kundërshtimet e lartpërmendura në lidhje me kompetencat e Gjykatësit të Vetëm janë të pabaza.

#### D. INFORMACIONI DHE MATERIALI I DHËNË MBROJTJES

35. Mbrojtja parashtron se i gjithë materiali dhe provat që kanë të bëjnë me të dyshuarit duhet të nxirren që të (i) plotësojnë informacionin e pamjaftueshëm të marrë pas arrestimit;<sup>50</sup> dhe (ii) t'i mundësojnë Mbrojtjes që të kundërshtojë arrestimet.<sup>51</sup> ZPS-ja përgjigjet se fletarrestimet i kanë informuar plotësisht të dyshuarit për arsyet e arrestimit të tyre dhe i kanë dhënë Mbrojtjes informacion të mjaftueshëm për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit.<sup>52</sup> ZPS-ja shton se kërkesa e saj për fletarrestime

---

<sup>47</sup> Vendimi i caktimit, para. 15.

<sup>48</sup> Vendimi i caktimit, para. 16.

<sup>49</sup> Vendimi i caktimit, para. 13.

<sup>50</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 3-4, 8. Kërkesa e dytë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 7.

<sup>51</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 4-5, 8. Kërkesa e dytë e Mbrojtjes së z. Gucati, para. 6, 8-11.

<sup>52</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 2; Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucatit, para. 3.

dhe materiali i plotë mbështetës janë nxjerrë,<sup>53</sup> me riklasifikimet shtesë në përpunim e sipër.<sup>54</sup>

36. Në lidhje me informacionin që u është dhënë të dyshuarve pas arrestimit, Gjykatësi i Vetëm kujton se, në pajtim me nenin 41(4)(a) të Ligjit dhe rregullën 53(2) të Rregullores, fletarrestimet përmbanin informacion të hollësishëm për sjelljen e të dyshuarve në lidhje me veprat penale që pretendohet se janë kryer dhe për domosdoshmërinë e arrestimit, duke përfshirë paraqitjen e veprave penale konkrete dhe përshkrimin e shkurtër të fakteve që pretendohet se përbëjnë ato vepra penale.<sup>55</sup> Rrjedhimisht, fletarrestimet ishin formalisht në pajtim me nenin 41(4)(a) të Ligjit dhe përmbanin informacion të mjaftueshëm për t'iu mundësuar të dyshuarve që të kundërshtojnë arrestimin e tyre.

37. Në lidhje me nxjerrjet e mëtejshme të dokumenteve që kanë të bëjnë me arrestimin dhe paraburgimin e të dyshuarve, Gjykatësi i Vetëm vë në dukje se të dy kërkesat e ZPS-së për fletarrestime me shtojcat që përmbanin, ndër të tjera, transkriptet e konferencave të lartpërmendura për shtyp, dhe vendimin e Gjykatësit të Vetëm për fletarrestimet janë nxjerrë për Mbrojtjen brenda afateve për kundërpërgjigje.<sup>56</sup> Deri më sot, të gjitha parashtrimet e protokolluara që kanë të bëjnë me arrestimin, transferimin dhe paraburgimin e të dyshuarve janë nxjerrë për Mbrojtjen në kopje të redaktuara ose përmes riklasifikimit.<sup>57</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm konstaton se Mbrojtja

---

<sup>53</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 2; Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesave të Gucatit, para. 3.

<sup>54</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 2.

<sup>55</sup> Fletarrestimi për z. Gucati, para. 1-6; Fletarrestimi për z. Haradinaj, para. 1-6.

<sup>56</sup> Kërkesa e ZPS-së për fletarrestime (F00009 me shtojcat F00009/A01 dhe F00009/A02) iu bë e njohur Mbrojtjes në versionin e redaktuar konfidencial më 1 tetor 2020. Vendimi për fletarrestime (F00012) u riklasifikua si publik më 9 tetor 2020.

<sup>57</sup> KSC-BC-2020-07, F00036, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për parashtrime në lidhje me riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara*, 30 shtator 2020, konfidencial.

është informuar me kohë për të gjitha dokumentet që kanë lidhje me arrestimin dhe ka qenë në gjendje të bënte parashtrimet përkatëse.

38. Për sa më lart, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kundërshtimet e lartpërmendura në lidhje me informacionin dhe materialin e dhënë Mbrojtjes janë të pabaza.

#### E. SHKELJET E KUSHTETUTËS

39. Mbrojtja e z. Haradinaj parashtron se për shkak të arrestimit dhe paraburgimit, zotit Haradinaj iu shkelën të drejtat e tij kushtetuese për liri të shprehjes, lirinë e mediave, lirinë e tubimit dhe lirinë e asociimit si dhe u shkel parimi i proporcionalitetit sipas nenit 33(3) të Kushtetutës.<sup>58</sup> ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e z. Haradinaj gabimisht bazohet në nenet 40-44 të Kushtetutës dhe se liritë e përmendura atje janë objekt i kufizimeve të domosdoshme në pajtim me ligjin.<sup>59</sup>

40. Gjykatësi i Vetëm vë në dukje se, në pajtim me nenet 40(2), 41(2), 43, 44(3) dhe 55 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë ato që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes, lirinë e mediave, lirinë e tubimit dhe lirinë e asociimit, mund të kufizohen me ligj. Ndalimi i veprave të përmendura në nenet 387, 388 dhe 392 të KPK-së 2019 mund të kufizojë disa nga liritë e lartpërmendura me qëllim të mbrojtjes së administrimit të drejtësisë, përfshirë sigurinë dhe konfidencialitetin e procedurave penale dhe sigurinë e dëshmitarëve. Fletarrestimi kundër z. Haradinaj është lëshuar në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit në lidhje me veprat e pretenduara të penalizuara nga dispozitat e lartpërmendura. Gjykatësi i Vetëm më tej vë në dukje se neni 33(3) i Kushtetutës nuk është i zbatueshëm në këtë fazë të procesit, meqenëse nuk është nxjerrë asnjë vendim për përcaktimin e dënimit përfundimtar.

---

<sup>58</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 2.

<sup>59</sup> Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës së Haradinajt, para. 6.

41. Për sa më lart, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kundërshtimet e lartpërmendura në lidhje me shkeljen e të drejtave të z. Haradinaj janë të pabaza.

#### F. FAZA E PROCESIT

42. Mbrojtja a z. Haradinaj parashtron se informacioni i dhënë në fletarrestim nuk i përmbush kërkesat e rregullës 86(3) të Rregullores dhe për këtë arsye Gjykatësi i Vetëm duhet t'i hedhë poshtë akuzat.<sup>60</sup> ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Mbrojtjes duhet të hidhen poshtë menjëherë përderisa bazohen në dispozita të pazbatueshme, në lidhje me parashtrimin apo konfirmimin e aktakuzës.

43. Gjykatësi i Vetëm nënvizon se, deri më sot, asnjë aktakuzë nuk është dorëzuar kundër të dyshuarve. Siç është vënë në dukje më lart, arrestimi i tyre u urdhërua në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit me dyshimin e bazuar se kanë kryer vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit. Dispozitat e Ligjit dhe të Rregullores që kanë të bëjnë me parashtrimin dhe konfirmimin e aktakuzës nuk janë të zbatueshme në këtë fazë të procesit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm nuk do t'i shqyrtojë më tej argumentet e lartpërmendura.

44. Për sa më lart, Gjykatësi i Vetëm hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes së z. Haradinaj në lidhje me aktakuzën dhe akuzat.

#### G. KËRKESË PËR SEANCË GOJORE

45. Mbrojtja e z. Gucati kërkon nga Kryetarja që, ndër të tjera, të caktojë gjykatës tjetër për një seancë për të vendosur në lidhje me mocionet e z. Gucati që kundërshtojnë

---

<sup>60</sup> Kërkesa e Mbrojtjes së z. Haradinaj, f. 4,5, 8.

